

VOTA JONË



Unë do të votoj



Mbi moshën 18 vjeçare



Përgjegjësi qytetare

ZGJEDHJA JONË

KUVENDI - SHTËPIA E LIGJEVE

ANDUEN (12), MUHAMED (12), ERSÄ (13), AGNESÄ (12)



Ne iu ftojmë ta lexoni këtë artikull sepse flet për të drejtat dhe ligjet në demokraci

Sot ne fëmijët e klasës së VII-të, mësuam për Kuvendin e Kosovës dhe ligjet e ndryshme, të cilat miratohen pikërisht në këtë institucion. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm. Mësuam se Kosova ushtron autoritetin e saj, bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të të gjithë individëve. Lirinë dhe këto të drejta i kemi të garantuara me ligj.

Qytetarët të cilët nuk i respektojnë ligjet, mund të dënohen për veprat e bëra. Për shembull, veprat e tilla mund të përfshijnë: vjedhjen, korrupsionin, kidnapimin, shkaktimin e dëmit në prona publike, largimin e dhunshëm të një personi, etj.

Zbatimi i ligjeve në jetën tonë është shumë i rëndësishëm. Qytetarët mund të ndjehen më të sigurt dhe mund të gëzojnë të drejtat e tyre. Këto të drejta janë: e drejta e familjes, e drejta e mbrojtjes së pronës, e drejta e angazhimit në aktivitete, e drejta e strehimit, etj.

Ne duhet të jemi të përgjegjshëm kundrejt këtyre të drejtave duke i respektuar ato për vete dhe për qytetarët e tjerë. Ata qytetarë mbi moshën 18 vjeçare të cilët konsiderohen personat të moshës madhore, kanë të drejtën e votës dhe duhet të jenë të përgjegjshëm duke votuar përfaqësuesit e vendit.

E ardhmja e vendit jemi ne fëmijët, prandaj këto liri dhe të drejta që i kemi duhet t'i shfrytëzojmë sa më mirë.



Ne si fëmijë e kemi të drejtën e shkollimit. Përgjegjësia jonë është të mësojmë, të respektojmë orarin mësimor dhe të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin



Në demokraci të gjithë e kemi të drejtën për ta shprehur mendimin, por përgjegjësia jonë është ta dëgjojmë tjetrin dhe ta respektojmë mendimin e secilit

Përkushtimi dhe vullneti ynë për rolin e sofëm si gazetarë të demokracisë është shumë i madh. Prandaj, përveç artikujve që i kemi shkruajtur, ne kemi bërë edhe punime të tjera, të cilat lidhen me demokracinë. Këto punime dhe përshkrimin e domethënies së tyre mund t'i shihni më poshtë



Të votosh nuk është vetëm e drejtë, ajo është edhe përgjegjësia jonë në një shtet demokratik



Qeverisja e demokracisë promovon barazi, si në aspektin gjinor, ashtu edhe në aspektet e tjera



Ligjet të cilat miratohen në Kuvendin e Kosovës, na e rregullojnë mënyrën e jetesës sonë



Unë jam ligji. Nëse ju qytetarë të nderuar shkelni mbi mua, gjykata do t'iu gjykojë



Në demokraci ka barazi, të drejta, tolerancë, e mbi të gjitha ka respekt, ku fjala e tjetrit respektohet me të dëgjuar



Albini ka një talent të veçantë në pikturë. Sot, ai është argëtuar shumë duke vizatuar

PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE, PËRGJEGJËSI E JONA

ALBIN (12), DIOLA (12), DORIAN (12), RINESA (12), RINOR (12)



Në demokraci sovranitetin mund ta ushtrojmë përmes pjesëmarrjes sonë në procesin zgjedhor

Zgjedhjet e përditshme janë shumë të rëndësishme për ne, por zgjedhjet lokale dhe ato qendrore janë të rëndësishme për të gjithë Kosovën

Unë Doriani dhe Rinori, jemi shokë të ngushtë që nga klasa e I-rë. Por, ne dallojmë nga njëri-tjetri në shumë fusha. Për shembull, që kur kam qenë i vogël, mua më kanë pëlqyer shumë aeroplanët dhe helikopterët. Andaj, planifikoj që në të ardhmen të bëhem pilot i suksesshëm. Për dallim prej meje, Rinori ka interesa të tjera. Ai çdo herë ishte shumë i fokusuar në biznesin e familjes së tij. Biznes ky i cili ka të bëjë me zdrukthëtarë. Pa dyshim që ai do ta vazhdojë këtë traditë familjare gjatë gjithë jetës së tij. E gjithë kjo neve nuk na ka bërë më pak shokë se që jemi. Kjo dëshmon që secili prej nesh vendos në mënyrën e vet dhe pa imponime. Kjo është njëra prej zgjedhjeve tona që ne

kemi planifikuar ta bëjmë. Por, kur ne do t'i mbushim 18 vjet, do të votojmë në mënyrë të ndarë. Vota është e fshehtë dhe çdo kush vendos për veten e tij se për kë do të votojë. Kjo varet nga preferenca e personit. Me pjesëmarrjen tonë në procesin zgjedhor, ne mund



Duke votuar për zgjedhjen e kryetarit të klasës



Jemi krenarë me punën tonë si gazetarë

të kontribuojmë në përmirësimin e gjendjes në komunat tona, por edhe në gjithë Kosovën. Zgjedhjet lokale përfshijnë aktivizimin tonë duke votuar për kryetar të komunës dhe asamblistët. Ndërsa, zgjedhjet qendrore kanë të bëjnë me zgjedhjen e deputetëve, të cilët për 4 vjet radhazi do të na përfaqësojnë neve në Kuvendin e Kosovës. Ne e kemi ndarë mendjen tonë dhe kemi vendosur të votojmë kur të mbushim 18 vjet. Votoni edhe ju, bashkëqytetarë të dashur, sepse vetëm në atë mënyrë mund ta forcojmë demokracinë.

DEMOKRACIA DHE MEDIA

ARTAN (12), ANJEZA (12), RIGON (12), RIOLA (12), VALON (13)

Ne mendojmë se media nuk funksionon lirshëm pa demokraci dhe demokracia nuk funksionon ashtu siç duhet pa media

Demokracia është e nevojshme për qytetarët e një shteti. Fjala demokraci do të thotë udhëheqje e popullit. Populli ndikon shumë në demokraci me anë të votës së lirë. Por, qytetarët për të zgjedhur duhet të jenë të informuar. Qytetarët informohen nga media dhe ajo është shumë e nevojshme. Media e informon qytetarin në shumë raste. Për shembull, për sport, çështje sociale, etj.

Si mjet informues shumë i rëndësishëm është edhe interneti. Qytetarët përdorin internetin dhe rrjetet sociale për qëllime të ndryshme. Është e vërtetë që ne i përdorim ato për argëtim, por në të njëjtën kohë ne i përdorim ato edhe për t'u informuar. Pra, media është shumë e rëndësishme për një shtet të zhvilluar dhe demokratik.



Gazetarët e e këtij artikulli



Anjeza në rolin e gazetares duke e pyetur Artanin



Mendimi i Artanit për rolin e medias në demokraci



Gjatë punës si gazetar



Media elektronike



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: VII-3
Vendi: Prishtinë